



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 540/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës jo qeveritare Nvo Centre for social inclusion Gracanica-CSIG- Bojan Sekuliq, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.540/2021 e datës 02.03.2021, e paraqitur nga Organizata jo qeveritare Nvo Centre for social inclusion-CSIG- Bojan Sekuliq, me seli në Graçanicë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallen të pavlefshëm votat nga qendra e votimit numër 1001x/04D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 02.03.2021, ka pranuar një ankesë Anr.540/2021, nga Organizatës jo qeveritare Nvo Centre for social inclusion-CSIG, me seli në Graçanicë, në të cilën pretendohet se vëzhguesi i kësaj organizate me numër personal 1233774843 më datë 01.03.2021 në ora 12:30 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë verifikimit të votave me kusht të vendvotimit numër 1001x/04D ka vërejtur që zarfi numër 050/050 është pa nënshkrim (që është një detyrim dhe parakusht që fletëvotimi të konsiderohet i vlefshëm) i hapur dhe vota i është caktuar një subjekti politik. Më tutje pretendohet se vëzhguesi Ivanoviq Milosh, pasi inspektoi dhe kontrolloi votat me kusht nga vendvotimi numër 1001x / 04D, menjëherë ka reaguar dhe e ka informuar përfaqësuesin-drejtorin e OJQ-së Nvo Centre For Social Inclusion Gracanica-CSIG- Bojan Sekuliq me numër personal 1502038199. Në vazhdim pretendohet se kjo parregullsi i referohet kutisë së votave me kusht QV110/003 nga komuna e Kamenicës. Sipas pretenduesit të ankesës, në bazë të autorizimit nga neni 56, paragrafi 1, pika c) të Ligjit për Zgjedhjet të Përgjithshme të Republikës së Kosovës nr. 03 L 073 obligimi i vëzhguesit është të monitorojë paketimin, transportimin, përpunimin, numërimin, ruajtjen e sigurt dhe hapjen e kutive të votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se duke marrë parasysh se numërimi i votave është një nga fazat më të rëndësishme në procesin zgjedhor, dështimi i përfundimit të numërimit dhe transferimi i rezultateve në mënyrë të shpejtë dhe transparent të rrezikoj besimin publik, si dhe vetë procesin e zgjedhjeve si dhe duke besuar se integriteti i votës së çdo qytetari është një e drejtë e përcaktuar ligjërisht për të votuar në një shoqëri të organizuar demokratike është mënyra transparente dhe

efikase e numërimit të votave është e nevojshme sepse do të parandalonte manipulimin e mundshëm të votave dhe do ta ruante besimin në procesin e numërimit. Parashtruesi i ankesës në bazë të arsyeve dhe fakteve të cekura, si dhe duke pasur parasysh nenin 5 të Ligjit nr. 03/ 265 Për Ndryshimet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr. 03/ L 073, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, i propozon që të merret vendim dhe të anulohet votat nga qendra e votimit numër 1001x/04D dhe ti shpallë të pavlefshme.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 02.03.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se votuesi është aprovuar se në listën Votuese me kusht, i posedon të gjitha të dhënat duke përfshirë edhe nënshkrimin. Në përgjigje theksohet se votuesi në listën votuese me kusht gjenden me numër 27 me të dhënat e njëjta me zarf numër 50/50. Përgjigjes ka bashkangjitur listën votuese me kusht, ku është i përfshirë votuesi me numër dhe zarfin e fletëvotimit me kusht për votuesin me zarf numër 50/50.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 1001/04D është verifikuar zarfi me numër 050/050, i cili ishte pa nënshkrim dhe i hapur, vota iu është caktuar një subjekti politik në mënyrë të rregullt për të cilin kishte votuar votuesi, prandaj si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Organizata jo qeveritare Nvo Centre for social inclusion-CSIG, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky vendvotim të shpallet i pa vlefshëm sepse zarfi i fletëvotimit i cekur në ankesë ka qenë e pa nënshkruar, me të cilën është një detyrim dhe parakusht që fletëvotimi të konsiderohet i vlefshëm.

Paneli, me rastin e vendosjes së ankesës, ka verifikuar shkresat e lëndës me të cilën shihet se në Listën e Votuesve me kusht (Vendvotimit “VV” 1001/04D), janë të dhënat e votuesit, emri mbiemri, datëlindja dhe nënshkrimi i votuesit, lidhur me fletëvotimin e vendosur në zarfin 50/50, që rezulton se vlerësimi nga QNR-ja, që fletëvotimin në fjalë që e ka shpallur të drejt, ka qenë në harmoni me ligjin dhe procedimin e rregullt të fletëvotimit. Kështu që Paneli këtë pretendim në ankesë e refuzon si të pabazuar për arsye se nga të gjeturat është konstatuar se fletëvotimi në VV e lartcekur dhe zarfi në fjalë janë proceduar dhe në përputhje me nenin 18 paragrafi 3 i Rregullës Zgjedhore 9/2013.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme*

për të parandaluar padrejtësi serioze”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 540/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme, në afat prej 24 orëve nga dita e pranimet të këtij vendimi.